

STP . Te huajt Perkohesisht te Pranishem

Te huajve qe nuk bejne pjese ne Bashkimin European, te pranishem ne Itali pa leje qendrimi, keshtu te pamundur per tu shkruar ne Sherbimin shendetesor, ju sigurohen mjekimet ambulatorore dhe spitalore urgjente apo esenciale nepermjet certifikates **STP**.

Kodi **STP** është kod identifikues i perbere nga 16 germa:

tre germa perbehen nga shenja **STP**

tre germa te kodit **ISTAT** qe i i perket Rajonit

tre germa te kodit relativ te **Asl** qe leshon kodin

shtate germa qe i perkasin numrit ne **rritje** qe i atribuohet.

Kodi STP i jepet te huajit qe nuk ka leje qendrimi ne baze te nje deklarate qe leshon me te dhenat personale si dhe nje deklarate qe deshmon gjendje varferie.

Kodi STP vlen per te gjithë territorin shteteror italian dhe zgjat per **6 muaj**. Rinovohet ne rast se i huaji vazhdon qendrimin e tij ne territorin shteteror.

I huaji duhet te deklaroje prane Asl-it te dhenat personale si dhe nenshtetesine.

P.S. qytetaret Shqiptare, Boshnjake, Serbe, maqedonas, Mali i Zi (pjese ex Jugosllavia), titullare te pasaportes biometrike, kur hyjne ne Itali kane te drejten e qendrimin per tre muajjt e pare (90 dite) si turist.

Per kete aresye konsiderohen sikur te jene me rregulla dhe nuk kane STP.
(duhet te pajisen me sigurim shendetesor nga vendi i tyre perpara fluturimit)

Duhet kerkuar pasaporta dhe te kontrollohet viza e hyrjes ne Itali.

Nese mbas **90 diteve** mbas hyrjes, ky i huaj eshte ende i pranishem ne Itali, atehere i leshohet **STP**.

I huaji **STP**, kur ka nevojë per nje vizite mjekesore, nuk mundet te paraqitet prane mjekut te familjes, por i drejtohet **Qendres ISI**. Mjeku i Qendres **ISI** mundet te shkruaje vizita, analiza, ilaçe ose te propozoje shtrime.

Kerkesa per nje certifikate **STP** mundet te behet edhe nepermjet Drejtorise shendetesore te Spitalit me nje model qe parashikohet nga ligji.